

PROCESVERBAL - Tipi i kontrates – Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efektpublikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti / Procedurës: FV ELEKTROPOMPE PER STACIONIN E POMPIMIT LUGAR NJESIA DROPULL

REF-51787-06-19-2025

Vlera e Fondit Limit: 2 100 000 (dy million e njeqind mije) leke pa Tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autori teti/enti kontraktor SHRUKGJ sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:


I.Elektropompe Zhytse.

POMPA

Pompa te jete zhytse trupi gize,turbinat e punes te jene material celiku(Inoks)SS316, te kete eficence (**η**)minimumi 79-80% te cilat te paraqiten me kurbe ne grafikun e te dhenave teknike(Technical data sheet).Garanci te larte pune me uje qe permбан 100 g/m³.Dalja e pompes te jete e fllanxhuar dhe me fileto.Lartesia(hashi)maksimal te jete 500m,Pompa do punoje ne Presionin 40 bar dhe prurjet duhet te jene Q=100 m³/ore.

ELEKTROMOTORI

Efienca e elektromotorit te jete (**η**) minimum 88.4-88.8 %.Klasa e izolimit(mbrojtjes)te jete IP68.Te kete te istaluar ne trupin e elektromotorit fishekun e mbrojtjes te temperatures PT100.Elektromotori te jete me i fuqishem se pompa.



Dimisjonet e Pompes.

A	3992.5
B	2126.5
C	1866
D	215
E	242
F	G4
G	160
Ø max	251

Argumentim

Per te perballuar sasine e materialeve te ngurta(rere)qe shoqerohen bashke me ujin,pompa duhet te perballoje ngarkesen 100 g/m^3 .Dalja e pompes duhet te jete me fileto dhe fllanxhe per te realizuar lidhjen midis tubave ne te dyja format dhe me garanci te larte per shkak se presioni mbi pompe eshte 40 bar..Eficienca minimumi 79-80 % do ndihmoje ne harxhimin minimal te energjise.Turbinat prej metali Inoks 316 jane te rezisetueshme kundra gerryerjes te kriperave dhe lendeve gerryerese.Elektromotori duhet me i math se fuqia e pompes per shkak te perballoje uljen e tensionit ne momente te vecanta kur rrjeti i tensionit te mesem ngarkohet.Fisheku PT100 nevoitet per shkak se jep sinjal kur temperatura e elektromotorit ngrihet mbi normen e tija.

Larje dhe testim pusi.

a) Duke marre parasysh gjendjen gjeologjike te struktures se tokes ne kete zone e cila perbehet nga shtresa rere dhe zhavorre te imta pastrimi i pusit me ajer dhe solucion lares do ndimoje ne rikethimin e sasine te ujit qe ka qene ne fillim. Larja e pusit duhet te behet nga Autosonda shpimi te cilat e kane mundesine per uljen dhe ngritjen e tubave dhe per perzierjen e solucionit lares me ajrin e kompresorit.Autosonda duhet te kete dhe kompresor per te realizuar larjen e pusit.

b) Testimi i puseve

Per shkak te percaktimit te nivelit dinamik te pusit i cili nuk eshte ne kuoten qe ka qene kur u hapen puset,nevoitet testim 24-ore me pompe me inverter qe te caktohet niveli i sakte per te marre sasine prej 100m^3 uje ne ore.

Per te bere testimin e pusit nevoiten keto materiale

Elektropompe

Elektropompa sherben per matjen e sasine minimale dhe maksimale te ujit ne pus.Paneli Inverter sherben per t''ju pershtatur sasise te ujit (me uljen e ngritjen e herseve) qe do japi pusi)

Mates uji elektromekanik me fllanxha Dn 80 mm me dalje (4-20mA)

Matesi i ujit duhet elektromekanik per te matur ujin me saktesi dhe per te hedhur te dhenat ne komjuter (Laptop)

Mates i nivelit te ujit dixhital me dhenje diagrame.

Sherben per te matur uljen e nivelit te ujit ne pus dhe per ta lidhur me komjuterin (Laptopin)

Komjuter ose (Laptop)

Nevoitet per te nxjerre kurben dhe per te percaktuar sasine dhe thellesine te ujit ne pus.

Nr	Emertimi i mjetit	Sasia	Statusi
1	Autosonde	1	Pronësi ose me qira
2	Kompresor ajri	1	Pronësi ose me qira
3	Elektropompe zhytse,H=80 m,Q=100 m ³ /ore	1	Pronësi ose me qira
4	Inverter P=37 Kw	1	Pronësi ose me qira
5	Mates uji elektromekanik me fillanxha Dn 125 mm	1	Pronësi ose me qira
6	Kompjuter ose (Laptop)	1	Pronësi ose me qira
7	Mates i nivelit te ujit dixhital me dhenie diagrame	1	Pronësi ose me qira

Fuqia punetore 6 punetore (perfshire dhe FV pompa dhe larje pusi) ku te kete te pakten nje inxhinier mekanik dhe nje inxhinier gjeolog.

Për mjetet të paraqiten dokumentat e pronësise (fatura blerje,zhdoganimi etj, ndërsa për sondën lejë qarkullimi,akt kolaudimi dhe siguracion). Në rast të kontratave të qirasë krahas dokumentave të mësipërm të paraqiten dhe kontratat e qirase te vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave. Ne rast se kontrata e qirase perfundon perpara apo brenda afatit te zbatimit te kontrates se lidhur me AK, Kontraktori do te lidhe nje kontrate te re dhe do ta paraqite para AK.

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	cmimi
I	FV.Elektropompe zhytse,H=400m,Q=100m ³ /ore.	cope	1	x
II	Larje pusi me ajer dhe solucion	ore	4	8 000
III	Testim pusi me pompe	ore	24	2 000
	SHUMA			
	TVSH 20%			
	Totali me tvsh			

Afatet e lëvrimit: 5 dite kalendarike nga data e lidhjes se kontrates

2.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit,*
- b. *Sigurimin e Ofertës,*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Objekti i prokurimit te jete i pasqyruar dhe ne ekstraktin e shoqerise persa i perket veprimtarise ne fushen e mallrave te kerkuara nga AK

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

-Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare,2022 ,2023 dhe 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa 40% e vleres se parashikuar e kontrates.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Baza ligjore (VKM nr.285,datë 19,05,2021,ndryshuar neni 43,pika 1 "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklarave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare1"; neni 43,pika 2/c " Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: "40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme"; neni 55,pika 4 "Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave";neni 43/3 " Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor"

Argumentimi: Ky kriter vjen si rezultat i kërkesave të parashikuara sipas legjislacionit në fuqi për prokurimet publike dhe ka si qëllim të provohet para AK aftësia financiare, qendrueshmëria dhe vazhdueshmëria në fushën e veprimtarisë të OE.

2.3 Kapaciteti teknik:

I-Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së prokuruar të kësaj kontrate përkatësisht _____ lekë pa tvsh. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,**
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.(VKM neni 40/4)**

Baza ligjore (VKM nr.285,datë 19,05,2021,ndryshuar neni 40,pika 4 “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. “neni 55,pika 4/b “ Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”.

Argumentimi: Ky kriter vjen si rezultat i kërkesave të parashikuara sipas legjislacionit në fuqi për prokurimet publike dhe ka si qëllim të provohet para AK veprimtaria në objektin e prokurimit ose në mallra të ngjashme, çka rrit besueshmërinë e OE për realizimin e kontratës.

II-Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001:2015 për Menaxhimin e Cilësisë, ose e përditësuar ku te jete pasqyruar objekti i prokurimit (Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikaten ISO sipas zerave te mallrave qe do te marre persiper sipas akt-marreveshjes.) Në rast se certifikata është në gjuhe të huaj operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën përkatëse (të përkthyer dhe të noterizuar).

Baza ligjore (VKM nr.285,datë 19,05,2021,ndryshuar neni 44,pika 1” Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

Argumentimi: Ky kriter vendoset për arsye se OE që vepron në fushën e objektit të prokurimit nëpërmjet kësaj certifikate duhet të jetë garantues sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit të tij.

POMPA

-Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi me numrin e references te procedures se prokurimit. Ne rast se ne procedure do te paraqitet vete prodhuesi ose distributori kriteri i parashikuar me lart nuk do te merret i mireqene ne ofertat perkatese.(Preferohet qe fabrika e prodhimit të jetë në një vend të Bashkimit Evropian ose Shteteve të Bashkuara të Amerikës)

-Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Ne rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi OE duhet te paraqese dokumentacionin per te vertetuar lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Argumentim :ky kriter vendost pasi provon vijueshmërinë dhe besueshmërinë e OE në fushën e prokurimit,pasi ky OE rezulton të jetë klient i vazhdueshëm për mallrat objekt prokurimit. Kriteri i vlerësimit nga AK është oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim. Kjo nuk pengon asnjë OE të paraqesë të dhëna për mallrat objekt prokurimi që nuk janë prodhuar në vendet e BE apo SHBA, por që plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara dhe ofrojnë cilësi sipas standarteve te BE. Nga ana e AK është përcaktuar fjala “preferohet” çka nuk tregon detyrim për vendin e origjinës së mallit.Për këtë arsye AK nuk ka përcaktuar detyrimisht se është e detyrueshme që fabrika e prodhimit të jetë në një vend të Bashkimit Evropian ose Shteteve të Bashkuara të Amerikës”ose “fabrika e

prodhimin të jetë në një vend të Bashkimit Evropian ose Shteteve të Bashkuara të Amerikës”sepse do të ndodheshim në kushtet e parashikuara nga nenin 3/2 të Ligjit 162/2020,ndryshuar kur është përcaktuar vendi i prodhimin të mallit , duke cënuar konkurrencën. Sikundër u sqarua më lart ky paragraf nuk ndikon në vlerësimin e ofertave dhe as në origjinën e mallit që do të ofrohet nga çdo OE për sa kohë ky mall (pavarësisht ku është prodhuar) plotëson specifikimet teknike të kërkuara nga AK dhe garanton cilësi të lartë.

-Deklarata OE e konformitetit për pompën dhe për motorin elektrik zhytes, shoqeruar me Certifikata e kalibrimit të instrumentit të laboratorit të testimit të prodhuesit (matës të rrjedhës, manometra, vakum metraWatt-metro, etj.), Nga një kalibrim i fundit nga institutet anëtare të "Europeanco-operation for Accreditation" (EA) ose ekuivalent.

-Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese në sistemin elektronik datasheet të prodhuesit te mallrave objekt prokurimi ku te pasqyrohet qe rendimenti i efciences se elektropompe /ve te jete jo me pak se 79-80%. Në rast se katalogjet apo broshurat janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe sipas legjislacionit në fuqi.

Baza ligjore (VKM nr.285,datë 19,05,2021,ndryshuar neni 40,pika 6,gërma b dhe c”

Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.c) fotografitë apo katalogët teknikë

Argumentimi: Ky kriter vendost për arsye se malli objekt prokurimi duhet të jetë i gatshëm në çdo moment për tu vendosur në punë dhe se duhet të jepet garancia që është provuar dhe testuar duke përmbushur dhe specifikimet e kërkuara .Kjo kërkesë ka si qëllim garantimin e Autoritetit Kontraktor për testimet e kryera për mallin që do të furnizohet,pasi nga malli objekt prokurimi duhet të jetë i gatshëm në çdo moment për tu vendosur në punë pas përfundimit të ekzekutimit të kontratës. Në lidhje me institucionin që do të lëshojë certifikatën e kalibrimit. Në lidhje me përcaktimin e "Europeanco-operation for Accreditation" (EA) nga Shkurti 2021 anëtare është dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA Albania).

-Operatori Ekonomik duhet qe ne momentin e dorezimit te paraqese certifikatat ISO :9001-2015 , certifikata qe produktet dhe elementet jane te pershtatshme ne kontaktet me ujin e pijshem. Certifikata e përshtatshmërisë për ujë të pijshëm të pompave dhe motorëve elektrikë. Certifikatat duhet të lëshohen nga organet e mëposhtme evropiane të pavarura:

1) ACS– Attestation de conformité sanitaire (ACS)- Certifikata e konformitetit shendetesor France

miratuar nga :

**MINISTÈRE DE LA SANTÉ, DE LA FAMILLE ET DES PERSONNES
HANDICAPÉES Direction générale de la santé
MINISTRIA E SHËNDETIT DHE FAMILJES DHE PERSONAT ME AFTËSI TË
KUFIZUARA**

**Drejtorja e Përgjithshme e Shëndetësisë
bazuar ne:**

Circulaire DGS/SD 7 A n° 2002-571 du 25 novembre 2002 relative aux modalités de vérification de la conformité sanitaire des matériaux constitutifs d'accessoires ou de sous-ensembles d'accessoires, constitués d'éléments organiques entrant au contact d'eau destinée à la consommation humaine

Qarkorja DGS/SD 7 A Nr. 2002-571 e datës 25 nëntor 2002 në lidhje me procedurat për verifikimin e konformitetit shëndetësor të materialeve që përbëjnë aksesoret ose nën-bashkimet e aksesoreve, të përbërë nga elementë organikë që vijnë në kontakt me ujin e destinuar për konsum njerëzor

2) NSF REG 4 Certification -United Kingdom – Certifikimi NSF REG 4 - Mbretëria e Bashkuar

3)UBA (Umweltbundesamt)-Agjencia Gjermane e Mjedisit bazuar ne TrinkwV-Urdheresa e Ujit te Pijshem

4)ICIM bazuar ne DM 174 - Dekreti Ministror nr. 174 i datës 06/04/2007 përcakton kërkesat e materialeve të destinuara për t'u përdorur në kontakt me ujin e pijshëm - Itali ose ekuivalentet e tyre

Argumentim:Në lidhje me kërkesën për certifikatën ISO 9001-2015 dhe 14001:2015 të prodhuesit në momentin e dorëzimit të mallit sqarojmë paraprakisht se ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë cilësinë dhe uljen e rrezikut për blerësin përfundimtar AK për shkak të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga prodhuesi/furnizuesi, përshtatshmërinë e cilesive burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizajnimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e

konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve dhe ndermarrjen e veprime korigjuese. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit të tij.

Në kushtet kur malli objekt prokurimi është i një rëndësie të veçantë pasi do të përdoret për furnizimin me ujë të pijshëm të popullsisë detyrimisht që për arsyet e lartpërmendura për certifikatën ISO 9001 :2015 kërkohet që ky dokument të zotërohet dhe nga prodhuesi i mallit. Duke qenë të qartë (duke studiuar dhe tregun vendas) që në Shqipëri nuk ka prodhues të pompave të ujit dhe elektromotorëve dhe ky mall vjen nga importi, pavarësisht se kjo kërkesë nëpërmjet OE fitues i drejtohet një pale tjetër (prodhuesit) jo vetëm që garanton cilësinë e mallit të prodhuar, por dhe për arsye të tjera që nuk varen nga AK ose OE fitohet kohë duke u shmangur verifikimi i të dhënave të prodhuesit nga AK. Gjithashtu kërkimi i certifikatave të cilësisë siç u përmend ka të bëjë me mallin objekt prokurimi, rëndësinë e tij duke qenë i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit dhe të provohet fakti që janë të përshtatshme për kontaktin me ujin e pijshëm .

Në lidhje me përcaktimin “Certifikatat duhet të lëshohen nga organet e mëposhtme evropiane të pavarura” qëllimi i AK ka qenë që dokumentacioni i kërkuar të lëshohet nga një institucion i pavarur që nuk ka lidhje me prodhuesin e mallit. Nga ana e AK është përcaktuar dhe termi “ekuivalent” ,çka nënkupton se dokumentacioni mund të vijë nga cilido institucion kombëtar apo ndërkombëtar që nuk është i lidhur me prodhuesin.

PASTRIM DHE TESTIM PUSI

Mjetet (pronesi ose me qira):

-autosonde (per zhbllokimin e mbetjeve te aluvioneve te pusit dhe uljen dhe ngritjen e tubave te solucionit)

-kompresor (per futjen me presion te ajrit dhe solucionit ne pus)

Testimi i puseve

Per shkak te shfrytezimit pa kriter te ujerave nentokesore dhe per shkak te renies te pakte te shirave dhe debores(efekt i ngrohies globale ne 10-vjecarin e fundit)keto puse kane ulur rendimentin e ujit prandaj nevoitet testimi i tyre per te percaktuar thellesine e elektropompe me poshte,per te rimare perseri te njejten sasi uji.

Per te bere testimin e puseve nevoiten keto paisje.

-elektropompe zhytese $H=80$ m, $Q=100$ m³/ore e pajisur me inverter me fuqi $P=37$ Kw

Mates uji elektromekanik me fllanxha Dn200mm dhe Dn 100mm me dalje (4-20mA)

Matesat e ujit duhen elektromekanik per te matur ujin me saktesi dhe per te hedhur te dhenat ne komjuter(Laptop)

Aparat me matje diagrame

Sherben per te matur uljen e nivelit te ujit ne pus dhe per ta lidhur me komjuterin(Laptopin)

Komjuter ose (Laptop)

Nevojitet per te nxjerre kurben dhe per te percaktuar sasine(Q) dhe thellesine(H) te ujit ne pus.

Fuqia punetore 5 (perfshire dhe FV pompa

2) NSF REG 4 Certification -United Kingdom – Certifikimi NSF REG 4 - Mbretëria e Bashkuar

3)UBA (Umweltbundesamt)-Agjencia Gjermane e Mjedisit bazuar ne TrinkwV-Urdheresa e Ujit te Pijshem

4)ICIM bazuar ne DM 174 - Dekreti Ministror nr. 174 i datës 06/04/2007 përcakton kërkesat e materialeve të destinuara për t'u përdorur në kontakt me ujin e pijshëm - Itali

ose ekuivalentet e barasvlefshme te tyre

H-Operatori Ekonomik fillimisht duhet te deklaroje ne SPE qe prodhuesi disponon certifikatat ISO :9001-2015 dhe ne momentin e dorezimit te mallit te paraqese certifikatat ISO :9001-2015 te prodhuesit ,

I-Te kete nje staf prej 6 personash ku te pakten te jete nje inxhinier mekanik dhe nje gjeolog, provuar me listagesat e tre muajve te fundit Mars-Prill-Maj 2025

J-Te kete licence NS-20 –A

K-Te kete mjetet e meposhtme:

Nr	Emertimi i mjetit	Sasia	Statusi
1	Autosonde	1	Pronësi ose me qira
2	Kompresor ajri	1	Pronësi ose me qira
3	Elektropompe zhytse,H=8m,Q=100 m ³ /ore	1	Pronësi ose me qira
4	Inverter P=37 Kw	1	Pronësi ose me qira
5	Mates uji elektromekanik me flanaxha Dn125 mm	1	Pronësi ose me qira
6	Kompjuter ose (Laptop)	1	Pronësi ose me qira
7	Mates i nivelit te ujit dixhital me dhenie diagrame	1	Pronësi ose me qira

Ky kriter fillimisht do te plotesohet me formularin e vetedeklarimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Njesia e Prokurimit